



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Procesverbal

nga takimi publik me qytetarë i mbajtur më 24 qershor 2021

Takimi filloi në orën 10.00

Takimin publik e hapi dhe e kryesoi z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës. Në takim ishte i pranishëm një numër i konsideruar i qytetarëve (49 pjesëmarrës); NënKryetarja e Komunës, Drejtorët e Drejtorive të Administratës së Komunës, përfaqësues të OJQ-ve, KFOR-i dhe përfaqësues të mediave.

Tema:

Realizimi i projekteve dhe aktiviteteve tjera të parapara në gjashtëmujorin e parë të vitit 2021, projektet dhe aktivitetet që janë në proces, si dhe ato të planifikuara për realizim

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, qytetarë të nderuar ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj dhe ju dëshiroj mirëseardhje në këtë takim.

Takimi është thirrur duke iu referuar dispozitave të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, Udhëzimit Administrativ përkatës si dhe Statutit të Komunës dhe ka për qëllim që Ju të jeni të informuar lidhur me ecurinë e realizimit të projekteve dhe të aktiviteteve tjera të parapara për vitin 2021, me theks të veçantë për gjashtëmujorin e parë, por sigurisht është edhe mundësi të shtroni pyetje, sugjerime dhe propozime apo të jepni vërejtjet e juaja lidhur me çështjet me interes të përgjithshëm. Në pika të shkurtra do të bëj një prezantim të cilin do ta shihni edhe në ekranin para jush, ku janë të përshkruara punët dhe aktivitetet të cilat Administrata komunale ka arritur t'i realizojë në gjashtë mujorin e parë dhe sigurisht pas kësaj do të keni edhe informacione tjera shtesë për punët dhe aktivitetet nga ana e Drejtorëve të Drejtorive dhe cilat janë të planifikuara gjatë këtij viti. Vërejtjet dhe sugjerimet e juaja eventuale do të merren parasysh. Ne si Ekzekutiv kemi trashëguar një projektbuxhet i cili është aprovuar pa ne, megjithatë jemi duke bërë përpjekje t'i përshtatemi atij projekt buxheti, përndryshe ka pas fusha dhe forma tjera që do të mund të parashiheshin më ndryshe, por meqë si të tillë e kemi në dispozicion ne e kemi për obligim zbatimin e tij. Po filloj me prezantimin:

Drejtoria e Administratës

Shumë prej punëve dhe aktivitete ndodhë që qytetarët të mos kenë informacione të mjaftuara sepse ne kemi kryere punë të shumta brenda përbrenda Administratës komunale. Varësisht kërkesave të shumta të qytetarëve nga ora 12:00-13:00 që është periudhë e pauzës, kemi krijuar një hapësirë dhe kemi harmonizuar orarin e punëtorëve, në mënyrë që Administrata të jetë e hapur për qytetarë për kryerje të shërbimeve edhe gjatë kohës së pauzës. Në funksion të transparencës kemi lansuar një projekt Alo Komuna, i cili projekt është i hapur gjatë tërë kohës me telefonata me qytetarë, ku qytetarët kanë mundësi që në çdo periudhë kohore të paraqesin, brengat, problemet apo shqetësimet e tyre të cilat lidhen me punën dhe fushëveprimin e Administratës komunale. Po ashtu me të marr pushtetin kemi realizuar një takim me Postën e Kosovës dhe kemi arritur pjesën e qendrës së qytetit ta mbulojmë me Wifi

falas. Është krijuar sistemi i pritjes në radhë, për shërbime më cilësore në mënyrë që qytetarët tanë të mos kenë pritje të gjata ku shërbimet do të kryhen më shpejtë, pa pritje të gjata sepse kemi porositur edhe aparaturat e reja dhe kjo pritet të aplikohet edhe në QKMF. Kemi filluar me realizimin e projektit *one stop shop* në mënyrë që qytetarët të kenë mundësi për kryerjen e shërbimeve brenda një zyre të vetëm pa pas nevojë të lëvizin prej një zyre në zyrën tjetër, në mënyrë që mos të maltretohen. Gjithashtu kemi aktivizuar një aparat fotokopjues brenda Komunës dhe kemi angazhuar një zyrtar që qytetarët të mund të kryejnë shërbimet pa pasur nevojë të dalin jashtë objektit të Komunës. Kemi arritur që shërbimet t'i avancojmë edhe në aspektin e pagesave postare. Gjithherë kur është bërë një pagesë është dashur të dilet jashtë objektit të komunës, tashmë kemi bërë një marrëveshje me PTT dhe këto shërbime mund të kryhen brenda përbrenda objektit të komunës. Këto janë disa prej punëve dhe shërbimeve të cilat janë kryer te Drejtoria e Administratës

Drejtorja e Buxhetit dhe Financave, te kjo Drejtori po ashtu kemi një sërë të punëve dhe aktiviteteve të cilat janë kryer gjatë kësaj periudhe kohore. Në radhë të parë për të rritur nivelin e transparencës komunale kemi krijuar platformën e *E-shpenzimeve* përmes së cilës shpenzimet e Komunës pasqyrohen në ueb sajtin e Komunës, ku në çdo kohë qytetarët e Komunës kanë mundësi të shohin shpenzimet financiare publike. Punë e mirë është bërë në realizimin e të hyrave vetanake, ku deri më sot kemi grumbulluar mbi 710,000 €, një shumë e mjeteve shumë më e madhe se më parë, për këtë periudhë kohore. Është realizuar një shumë e tatimit në pronë rreth 375,000 € që është një shumë e lartë e të hyrave që kemi arrit ta realizojmë në këtë periudhë kohore. Një çështje të cilën faktikisht nuk e kemi bërë shumë mediatike është se nga marrja e pushtetit kemi gjetur një numër të madh të ekonomive familjare të cilat fare nuk kanë qenë të regjistruara në sistemin e tatimit në pronë dhe ato ekonomi kanë qenë të kompanive të mëdha që realizojnë biznese të mëdha, e që pushteti i mëhershëm për çfarë arsye që ne realisht nuk i dimë i ka liruar nga tatimi në pronë, dhe ne kemi arritur që një numër të madh të këtyre ekonomive familjare t'i vëmë në sistemin e pagesave të tatimit në pronë, gjë që ka rezultuar në një grumbullim dhe mbledhje relativisht të mëdha të hyrave vetanake.

Drejtorja e Arsimit, janë realizuar projekte të ndryshme, vlen të theksohet shpërndarja nëpër shkolla e 112 titujve të ndryshëm, me më se 30,000 ekzemplarë të lekturave të ndryshme shkollore, në vlerë të përafërt 50,000 €. Ka vazhduar procesi i ndërtimit të fushave sportive në shfmu "Shefki Kuleta" në fshatin Bellopojë, shfmu "Shefki Latifi" në fshatin Pollatë dhe shfmu "Enver Maloku" në Podujevë. Po ashtu ka vazhduar projekti rreth eficiencës së energjisë elektrike në shkollën "Shaban Shala" dhe në shkollën "Shefki Kuleta". Janë ndarë bursa për studentë dhe nxënës të shkollave të mesme në shumë prej 52,800 €, ka qenë një proces i përcjell me telashe të mëdha për faktin që kemi një shumë relativisht të vogël të mjeteve të planifikuara nga Administrata e mëhershme ndërsa kërkesa shumë të mëdha të cilat kanë qenë vështirë për tu plotësuar. Ka filluar procesi i renovimit të çerdhes për fëmijë ku projekti është në proces të tenderimit. Kjo do të jetë çerdhja e dytë publike në qytetin e Podujevës. Ka filluar përmirësimi i infrastrukturës fizike në shumë shkolla, pajisje e shkollave me laboratorë, ku kemi nda një shumë të mjeteve prej 250,000 €. Kemi vazhduar me procesin e trajnimit të mësimdhënësve, sidomos të atyre të cilët kanë qenë të përgatitur dhe të interesuar për menaxhim dhe udhëheqje të shkollave. Vazhdimi i ndërtimit të objektit të shkollës fillore "Ali Ajeti" në fshatin Balloc ku ka zgjatur relativisht shumë procesi dhe shpresojmë që së shpejti të përmbyllet, mandej bashkëpunimi me kompanitë Santefarm dhe Santefruit për punën praktike të nxënësve të shkollës të mesme ekonomike Isa Boletini, ku nxënësit do të kenë mundësinë e ushtrimit të praktikës por njëkohësisht do të kenë mundësinë për realizimin e një pjese të hyrave për nevojat e tyre financiare. Është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi në mes Komunës së Podujevës dhe Caritasit zviceran ku 5 shkollave u është mundësuar inventarizimi i klasave parafillorë, pastaj memorandum bashkëpunimi në nivelin e shkollave profesionale me Komunën Kestel -Turqi ku kemi fituar

një projekt i cili do të avansojë aspektin e punës në teknologji dhe automatizëm. Janë shpërndarë diku 21 fotokopjues multifunksional për nevoja të shkollave.

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, është bërë një punë relativisht e mirë në kuadër të kësaj Drejtorie. E kemi gjetur në gjendje të rëndë për të mos thënë të mjerueshme, me pak kapacitete, me pak shërbime për qytetarë dhe me një jopërditshmëri në aspektin e zbatimit të kushteve të punës dhe orarit të punës. QKMF e kemi gjetur me 4 shtretër të cilët kanë qenë të dedikuar edhe për pacientët me covid 19 por edhe për të tjerët të cilët janë kontrolluar se e kanë apo jo covidin, kështu që ka qenë një potencial real që personat edhe nëse nuk kanë qenë të prekur me virusin covid dhe që janë vendosur në të njëjtit shtretër këta kanë mund të infektohen aty për aty. Puna e parë që është bërë ka qenë zgjerimi i kapaciteteve për të trajtuar këta pacientë; i kemi ndarë pacientët e infektuar nga pacientët tjerë; kemi krijuar kushte të nevojshme për trajtimin e këtyre pacientëve duke filluar me aparate për oksigjenim, duke krijuar staf të mjaftueshëm mjekësor të nivelit të mjekëve por edhe të motrave dhe mendoj se është menaxhuar relativisht situata. Kemi arrit për aktivizimin e shërbimit të patronazhit me orar prej orës 07:00 deri në ora 20:00 për trajtimin e pacientëve që nuk kanë mundësi të lëvizin dhe të marrin shërbimet mjekësore. Pra janë trajtuar me qindra dhe mijëra raste pa pasur nevojë për të ardhur në QKMF, duke i kryer shërbimet në shtëpi. Është funksionalizuar kontrata e re në vlerë 24,000 € në repartin e maternitetit dhe është eliminuar lista e pritjeve të gjata për pacientë të cilët kanë pritë me javë të tëra për kryerje të shërbimeve; pastaj funksionalizimi i laboratorit biohematologjik; janë kryer testet PCR edhe për bashkatdhetarët tanë; është funksionalizuar salla e infuzioneve në njësinë e emergjencës e cila ka qenë komplet jashtë funksionimit; kompletimi i repartit të stomatologjisë me pajisje dhe repromateriale, pasi që qytetarët nuk kanë pas mundësi ta kryejnë asnjë shërbim; përgatitja e sallës për fillimin e ligjëratave për stafin shëndetësor profesional; furnizimi me 5500 teste të shpejta për covid 19 dhe dhënia në shfrytëzim të një automjeti Qendrës së Shëndetit mendor në Podujevë; funksionalizimi i aparaturës laboratorike (kemi gjetur një aparaturë në laborator ku ka realizuar rreth 20 mostra gjatë orarit të punës, ndërsa kemi aktivizuar aparaturat të cilat brenda një ore kanë mundësi për trajtimin e 100 pacientëve për shërbime laboratorike të cilës do natyre qofshin); është funksionalizuar mamografi i cili ka qenë jashtë përdorimit; kemi filluar me dy ndërrime për shërbime shëndetësore në fshatrat Kërpimëh dhe Orllan, që deri më tani nuk ka qenë; ka filluar procesi i renovimit të objekteve shëndetësore në terren; kemi subvencionuar barëra për 240 familje në vlerë prej 27600 € dhe janë subvencionuar OJQ-të e ndryshme në vlerë të përgjithshme prej 20,000 €; janë dhuruar 4 shtëpi për 4 familje në nevojë, përveç atyre të cilat kanë qenë në proces dhe janë duke u realizuar nga organizata “Jetimat e Ballkanit” në bashkëpunim me Komunën. Gjatë këtij viti kemi nënshkruar edhe një memorandum bashkëpunimi me Organizatën “Jetimat e Ballkanit” për 10 shtëpi të reja dhe pritjet së shpejti nënshkrimi i një memorandumit aneks edhe për 5 shtëpi të reja.

Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, është në proces të realizimit të një sërë projekteve, ku veçohet projekti i ndërtimit të “Bulevardit të Qytetit” ku po vazhdon puna me intensitet në fazën e dytë të ndërtimit, ndërsa po punohet edhe në projekte tjera të kësaj fushe. Dinamika e punës në Bulevard është rritur dhe punët shpresoj të kryhen brenda afateve; po punohet në asfaltimin e rrugëve të planifikuara; së shpejti do të fillojmë edhe me fasadimin e objekteve në qendër; është bërë ndërtimi i parkingut në hapësirën mes objektit të Komunës së vjetër dhe të re, ku ky parking sadopak do të zbutë nevojat e qytetarëve; ka filluar procesi i asfaltimit të rrugëve në shumë të planifikuara mbi 1780,000 €; meremetimi i objekteve banesore, ku është ndarë një shumë mjeteve prej 200,000 €; mirëmbajtja e hapësirave publike etj.

Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, në kuadër të fushëveprimit ka kryer një sërë të projekteve dhe aktiviteteve, ku fillimisht është bërë identifikimi i pronave komunale, kemi arrit që disa prej këtyre pronave t'i vëmë në dispozicion të investitorëve të ndryshëm dhe

tashmë kemi rezultatet e para, objekti i cili për vite ka qëndruar i mbyllur në Sheshin e Qytetit e kemi dhënë në shfrytëzim dhe komuna çdo muaj realizon në emër të qeras shumë mujore prej 1500 € si të hyra vetanake. Për shkak të periudhës së shpalljes së zgjedhjeve pronat tjera komunale nuk kemi mundësi t'i japim në shfrytëzim.

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, në kuadër të kësaj Drejtorie është investuar në zgjerimin e hapësirave të bibliotekës së qytetit, si dhe është zgjatur ora e punës në bibliotekë. Në ora 4 kur ka përfunduar orari i punës në Administratën e Komunës është mbyllur edhe biblioteka, ndërsa ne e kemi lejuar punën në bibliotekë deri në ora 23:00; është pajisur me internet salla e leximit si dhe rregullimi i ndriçimit; është vendosur Arkivi në objektin e Komunës së vjetër, në bashkëpunim me Republikën e Shqipërisë është vendosur fondi arkivor i Republikës së Shqipërisë dhe në çfarëdo dokumenti që është në kuadër të Arkivave të Shqipërisë on-line nga Podujeva mund të kesh qasje. Është formuar Këshilli Drejtues i Teatrit të Qytetit “Avdush Hasani” dhe është zgjedhur Drejtori i Teatrit, sepse këtu ka qenë një tendencë që të gjitha institucionet komunale të drejtohen/ menaxhohen me ushtrues detyre, ndërsa ne nuk e kemi bërë një gjë të tillë, fjala vjen menjëherë kemi filluar me zgjedhjen e Drejtorëve të shkollave, Drejtorin e QKMF-së dhe shefat brenda përbrenda institucionit dhe këto institucione tashmë janë me drejtorë kompetentë. Kemi bërë thirrje për mbështetje financiare në vlerë prej 90,000 € për promovimin e shfaqjeve të ndryshme teatrore. Ka filluar renovimi i palestrës sportive “Hakif Zejnullahu”. Është bërë thirrje publike për disa morale që do të vendosen në pjesët kryesore të qytetit etj.

Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, është një diapazon i gjerë i punëve që janë kryer dhe që janë në proces. Kemi kryer me sukses mirëmbajtjen e dimërore; mirëmbajtja e kanalizimeve fekale dhe atmosferike; janë ndërtuar rreth 8 km kanalizime në qytet dhe fshatra; kemi shtrirje të rrugëve me zhavorr prej 22 km; mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve dhe hapësirave tjera publike në bashkëpunim me ndërmarrjen “Pastrimi”; Marrëveshje bashkëpunimi me Ministrinë e Zhvillimit rajonal për ndërtimin e urave në fshatrat Sfeçël, Gllamnik dhe Bajçinë; trajtimi i qenve endacak, kompania përkatëse është angazhuar, mirëpo në terren kemi një situatë tjetër, për shkak se numri i tyre është shumë i madh, megjithatë besoj se së shpejti do të arrijnë për të zgjedhur problemin e qenve endacak; mirëmbajtja e varrezave në disa lokalitete; ndërtimi në proces i 6 km trotuare; ndërtimi në proces i 11 urave dhe kalesave të ndryshme etj.

Drejtoria e Inspeksionit, po vazhdon punën në ndalimin e ndërtimit pa leje; gjatë punës së subjekteve shkelëse ndaj masave anticovid 19; inspektime të subjekteve afariste kundër shërbimit me pije alkoolike personave nën moshën 18 vjeç; identifikimi i deponive ilegale; parandalimi i prerjes së drunjëve sikurse jeni në dijeni është një dukuri e shprehur si dhe punë dhe aktivitete tjera inspektuese dhe të kontrollit.

Drejtoria e Bujqësisë Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural. Ka vazhduar me një numër projektesh të ndryshme. Paraprakisht ju njoftoj se kjo Drejtori përballet me problemet më të mëdha njëherë përnjëherë. Kemi pas dy probleme të cilat jemi duke bërë përpjekje për tejkalim. Problemi i parë është projekti i serrave, ku operatori ekonomik fitues i tenderit tërhiqet nga kontrata dhe si pasojë e kësaj jemi detyruar të shkëpusim kontratën, kemi konfiskuar sigurimin e tenderit dhe është iniciuar me procedurën që e njëjta nga Autoriteti përgjegjës të futet në listën e zezë. E njëjta gjë na ka përcjell me drunjtë dekorativ. Po ashtu një problem na ka shoqëruar me koshere të bletëve, ku kemi procedurë ankimore nga një operator ekonomik; është bërë një mbështetje financiare me 50 mullinj për fermerë; mbështetja me mëshqerra, farë misri dhe koncentre; mbështetja me mëshqerra për 70 fermerë (pjesa e dytë); mbështetje me fidan të mjedrave 50 fermerëve dhe thirrje publike për mbështetje me shoqëri bletësh për 105 fermerë.

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, po ashtu ka kryer një sërë punësh dhe veprime në fushën e saj. Vlen të veçohet marrëveshja me HELP-in për financimin për pajisje për punë për 20 gra ndërmarrëse, në vlerë rreth 50,000€; granti për gratë në bujqësi në

bashkëfinancim me Agjencinë për Zhvillimin Rural në vlerë 16,500 €; grante dhe trajnime për të rinjtë në ndërmarrësi në bashkëfinancim po ashtu me Agjencinë për Zhvillimin Rural në vlerë 6000€; funksionalizimi i shërbimit me palë pa pauzë; nënshkrimi i kontratës për studimin e fizibilitetit për ndërtimin e parkingut nëntokësor përmes formës me partneritet publiko privat.

Shpresoj se brenda afateve kohore do të realizojmë projektet të cilat janë planifikuar.

Besoj se me Ekzekutivin do të jemi në gjendje të përgjigjemi çdo pyetjeje dhe interesimin e Juaj. Mundësisht të flasim në emër të komunitetit, qoftë me kërkesa të natyrave të ndryshme, e jo me kërkesa personale, kërkesat të jenë të natyrës së përgjithshme, për lagjen apo komunitetin.

z. Imer Bajrami nga fshati Orllan, nuk e di se cili është Kryetar i fshatit Orllan, në mënyrë që kërkesat t'i bëjmë përmes tij. Vërejtja ime ka të bëjë sa i përket mbeturinave. Te Liqeni, ku thuhet plazha e 6, është mbushur me mbeturina. Kërkesa është që mundësisht të vendoset një kontejner për mbeturina, për të pastrua ambientin në atë pjesë.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, për çështjen e cekur nga parafolësi fillimisht dua të ju njoftoj se Kryetarët/përfaqësuesit e fshatrave nuk janë ndërrua, janë po të njëjtit. Është një projekt rregullorë që i referohet formimit dhe funksionimit të Këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane, e cila ka kaluar disa etapa dhe është në fazën gati finale të miratimit dhe në momentin që miratohet parashih disa rregulla të reja për procesin e zgjedhjes së Kryetarëve të fshatrave, në të cilën po ashtu parashihet fuzionimi i disa fshatrave me zgjedhjen e një Kryetari për disa lokalitete. Prandaj është po i njëjti individ që ka qenë deri më tani, përgjigja për fshatin Orllan.

Sa i përket mbeturinave, besoj se shumë shpejtë do ta zgjedhim këtë problem, këtu kam edhe drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit. Por ta keni parasysh një fakt, unë kam qenë shumë i interesuar që në këtë fazë për ti angazhuar 4-5 persona për mirëmbajtje të pjesës përgjatë Liqenit të Batllavës, mirëpo kemi shumë vështirësi për angazhimin e stafit shtesë. Për shkak të pengesave të Ligjit të ri nuk kemi mundur të shpallim konkurs publik përkundër faktit se kemi diku 20 vende të lira në Administratën komunale. Dje kisha një takim me zyrtarë të Kompanisë "Pastrimi" me qëllim të gjetjes së formës dhe mundësive për angazhim të stafit në hapësirat te liqeni i Batllavës gjatë periudhës së sezonit veror, për mirëmbajtje të hapësirës publike. Duhet pranuar faktin se edhe vet nuk jemi mjaftueshëm të ndërgjegjshëm për ruajtjen e ambientit.

z. Gëzim Krasniqi, nga fshati Halabak, theksoi, kanalizimin e kemi në gjendje të mjerueshme. Kemi bërë edhe peticion. Kërkojmë nga Drejtoria të dal dhe të shohë gjendjen.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, këtu kam drejtorin e DPUMM dhe drejtorin e DSHPMSh dhe besoj se do të trajtojnë çështjen e cekur nga parafolësi.

z. Bujar Hasni, lidhur me pyetjen e z. Gëzim Krasniqit, dua ta njoftoj se për vitin e ardhshëm është paraparë një kod buxhetor për përmbushjen e kërkesave të ngjashme, por gjithherë duke pasur parasysh kriteret fillimisht rastet që janë më urgjente dhe numrin e banorëve.

z. Fevzi Jetullahu, sikurse e ceku Drejtori Bujar Hasani, me kontratën për hartimin e projekteve do të përfshihet për trajtim edhe fshati Halabak.

z. Asdren Hoti, lagja te Posta – Podujevë, theksoi, banesat në afërsi të postës mbrapa objektit banor nuk kanë qasje në rrugë, është e nevojshme që kjo të rregullohet, rruga ka nevojë për ndërhyrje pak më të madhe.

z. Bujar Hasni, rruga ka nevojë për ndërhyrje më të madhe dhe në të ardhmen qasje do të kenë vetëm banorët e atyre banesave që frekuentojnë në qendër, është e dedikuar vetëm për banorët e asaj zone, ndërsa për banorët tjerë do të ketë zgjidhje tjera. Ajo rrugë shpejtë do të përfundojë, brenda muajit, me kubëza apo asfalt.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, ajo rrugë nuk është problem i sotit as i ditës së djeshme, qytetarët janë në dijëni dhe në kushte normale nuk është dashur të mbetet ashtu, por

duhet dhënë kuptimin çfarë duket ta ketë, por besoj se shumë shpejtë do ta zgjidhim atë problem.

z. Osman Sylja, përfaqësues i fshatit Llapashticë e Poshtme, kam disa kërkesa por edhe ankesa. Kërkesat nuk janë të sotit por të mëhershme. Kam një kërkesë për asfaltim të një rruge në qendër të fshatit, janë 5 familje pa asfalt dhe mendoj se kjo është bërë për shkaqe politike. Gjithashtu e kam bërë një kërkesë për asfaltim të një rruge te varrezat e fshatit ku janë familjet Latifi dhe Shabani(10 shtëpi). Kam bërë kërkesën për shtruarje me zhavorr prej përmendores "Bedri Ahmeti" lagja e Poterëve. Llapashtica e Poshtme është e vetmja para lagje e qytetit të Podujevës që deri më tani nuk e kemi pas asnjë metër trotuar. Këtë vit është bërë një meremetim i rrugëve sepse kanë qenë në gjendje shumë të keqe. Kërkesat nuk kanë munguar. Për një pasqyrë kam pritur një vit. Për dy pengesa në rrugë kam pritur një vit dhe ato janë shtruar dy ditë para zgjedhjeve.

z. Bujar Hasani, për fshatin Llapashticë është një kontratë dy vjeçare për asfaltim të rrugëve. Për vitin e ardhëm kemi planifikuar buxhet. Ndërsa për rrugët që kanë mbetur pa u përfunduar kompania e caktuar do të fillojë punët prej javës së ardhshme dhe ato do të përfundojnë. Me rishikimin e buxhetit do të shohim mundësitë edhe për ndonjë rrugë shtesë.

z. Fevzi Jetullahu, sa i përket kërkesave për fshatin Llapashticë e Poshtme këtë vit janë paraparë edhe trotuare. Ndërsa për rrugën me zhavorr kjo është e planifikuar, por nuk mund të them kohën kur do të realizohet, është çështje e procedurave të prokurimit. Sa i përket vendosjes së pasqyrave kemi kërkesa, mirëpo projekti është në prokurim, ka vonesa për shkak të ankesave dhe tenderi është në fazën e rivlerësimit.

z. Shefki Zeqiri, përfaqësues i fshatit Gërdoc; theksoi; për projekt Rregulloren për formimin dhe funksionimin e këshillave të fshatrave është mbajtur një diskutim publik dhe kam rekomanduar që të mos miratohet kjo Rregullore sepse nuk siguron bashkëpunimin dhe efikasitetin si dhe kryerjen e punëve të fshatrave në bashkëpunim me Komunën. Problem tjetër i qytetarëve por edhe bizneseve në zonën tonë është Rregullorja për orarin e punës së bizneseve. E vetmja Komuna e Podujevës e ka në fuqi këtë Rregullore e cila është në kundërshtim me Ligjin për Tregti të Lirë dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës. U përmend edhe një projekt për qentë endacak, ju rekomandoj që të veproni në përputhje me Ligjin për përkujdesjen ndaj kafshëve dhe Ligjin e veterinarisë. Sa i përket investimeve, fshati Gërdoc është një prej fshatrave që është investuar më së paku edhe pse vazhdimisht kemi bërë kërkesa. Kemi problem me kolektorin e ujërave të zeza i cili përfundon në fshatin Gërdoc, kjo shkakton shumë probleme te bizneset, bujqësi dhe te qytetarët, kjo është edhe në kundërshtim me ligjet dhe konventat ndërkombëtare. Kemi kërkesë për ndriçim publik, vetëm një pjesë e fshatit ka ndriçimin, pastaj për vendosjen e trotuareve, shenjzimin. Për ndërtimin e ambulantes kemi gjetur një donator i cili është i gatshëm për të investuar dhe ne kërkojmë vetëm pëlqimin prej Komunës. Gjithashtu kërkojmë edhe ndërtimin e disa rrugicave të fshatit. Ne i kemi përcjell debatet buxhetore edhe më parë por shpërndarja e mjeteve publike nuk po bëhet në mënyrë proporcionale

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, sa i përket Rregullores për formimin dhe funksionimin e Këshillave të fshatrave dhe lagjeve të qytetit, ajo nuk është e jona por është referuar prej institucioneve të shtetit dhe është mirë për të kontribuar në diskutim publik. Mirë është secili fshat të ketë kryetarin por pse e kanë paraparë kështu është çështje e tyre, mund të jetë edhe çështja financiare. Sa i përket orarit të punës së bizneseve këtë na e keni lënë ju dhe nuk po mund ta heqim, tri herë e procedojmë në Kuvend për heqje por nuk e votojnë anëtarët e Kuvendit të subjekteve LDK dhe PDK. Ju e dini kush e ka bllokuar qytetarin, jo ne dhe kjo duhet të hiqet. Në seancën e radhës sërish do ta procedojë me rend të ditës, vetëm ta heqim. Me tërë ekzekutivin jemi që ta heqim ditën e diel si ditë që nuk punohet. E përsëris, nuk është e jona, ju i keni vënë bllokadën qytetarëve dhe tashmë ne mundohemi ta heqim dhe na dalin kundër. Sa i përket qenve endacak, jemi duke punuar në përputhje me ligjin dhe çdo gjë është duke shkuar në mënyrë perfektë në përputhje me rregullativën ligjore.

për kolektorin, Komuna e Podujevës ka marrë kredi 5,300,000 €. Ky kolektor është prej keqpërdorimeve më të mëdha që ka mund të ndodh në Komunën e Podujevës, me të cilën jemi duke u përballur përditë. Punët kanë përfunduar në një gjatësi të vogël me një kosto jashtëzakonisht të lartë të këtyre gypave. Gypat janë vendos dhe ne duhet të gjejmë formë për të mënjeluar defektet që janë shkaktuar pa ne. Po punojmë në zgjedhjen e problemit, në veçanti në atë pjesë të ju. Kanalizimet e Llapit derdhen në lumenj, është duke u bërë krim, por nuk janë të sotit këto, që 20 vite është punuar me i derdhë aty. Nëse mendoni se për 6 muaj prej se kam marr pushtetin do t'i heq, keni gabuar se nuk mundem për këtë kohë. Jemi kah mundohemi për të gjetur formën dhe rrugën për të dalë prej asaj situate, por nuk është vetëm ky problem, ju e dini sa ka. Çështja e rrugëve, Gërdoci nuk është pa investime, i ka dritat, ndërsa unë në fshatin Lluga nuk i kam dhe nuk kanë edhe shumë lokalitete, po ashtu ka edhe trotuare, jo që nuk keni nevojë, sepse keni nevojë. Ne jemi duke punuar në Gërdoc, fjala është për ato tri familje atje që deri më tani askush nuk ka shkuar për shkaqe politike sepse ka pak vota atje, ndërsa unë jam duke punuar që t'i lidhim me rrugë edhe ato familje por jo për vota por për shkak të nevojave që kanë, jam duke i trajtuar ato që nuk janë trajtuar që 20 vite. Do ua rregulloj edhe fushën sepse ua kam premtuar dhe dua të ju sigurojë se të gjitha rrugët 50-200 m do ua rregulloj deri në vjeshtë, kjo vlen për të gjitha kërkesat, këtë merreni punë të kryer. Mos më kërkoni që të rregulloj 10 km rrugë sepse nuk jam në gjendje t'i kryej. Këtë vit do të rregullohen 17 km trotuare. Një numër i madh i punëve janë në fazën të gatshme për fillim. Rreth 88% e projekteve për vitin 2021 janë në procedura të prokurimit, asnjë punë, nuk do mbesin për kohën e zgjedhjeve sikurse kanë vepruar deri tash por i kam proceduar sipas planifikimit. Asnjë punë nuk do ta lë në kohën e zgjedhjeve. Por duhet ta keni parasysh edhe një fakt se ka kompani të qëllimshme që në momentin e fundit paraqesin ankesa në prokurim me qëllim të prolongimit të punëve dhe aktiviteteve. Jemi duke punuar shumë për zhbllokimin e këtyre pengesave.

z. Rexhep Dauti – përfaqësues i fshatit Llaushë; është një projekt për asfaltimin e disa rrugicave për asfaltim dhe e mirëpresim. Rrugën kryesore të fshatit “ Avdyl Dushkolli” që i lidh disa fshatra, me rreth 800 m gjatësi, baza i është bërë në vitin 2012 dhe ende nuk është asfaltuar. Gjithashtu kemi rrugën “Rrahim Tashevcit” e cila lidh dy shkollat e që është e nevojshme të rregullohet. I kemi edhe dy lagje (Imeri dhe Musliu) në zonë kufitare të cilat nuk kanë rrugë e as kanalizim, është shumë e nevojshme të trajtohen. Kemi kërkesë gjithashtu edhe për drita të fshatit.

z. Adem Ajeti, fshati Sfeçël, gjatë debatit të dëgjova për shumë punë dhe projekte të realizuara, që nuk i kam dëgjuar deri më tani. Kryetari e deklaroi se rrugicat do të kryhen të gjitha, unë për këtë e pata fjalën andaj nuk po e shoh të arsyeshme t'i paraqes kërkesat. Kam kërkesën për 500 m rrugë që nuk janë kryer edhe pse projektin e kemi vetëfinancuar në vitin 2015, kjo kërkesë është parashtruar edhe nga përfaqësuesi i fshatit.

z. Tefik Shalaku, lagja Shalaj, problemi ynë është i vjetër 21 vite, ne jemi në ujë, jemi 116 banorë, dhe janë diku 26 kërkesa në formë të peticionit duke filluar nga viti 2002. Në këto rrethana s'kemi si e presim vjeshtën.

z. Fevzi Jetullahu, ne veç se kemi kërkuar donacione për realizimin e këtij projekti. Projekti është i hartuar, është i gatshëm, kemi dorëzuar kërkesën në Ministri, në mënyrë që të na dalin në ndihmë, mirëpo nëse nuk mund të na ndihmojnë, të paktën do të bëjmë pastrimin e atyre tubacioneve aktuale.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, do ta zgjedhim atë problem, por ta dini që është problem 20 vjeçar. Problemi është se kanë ndërtuar shtëpi mbi kanalizim, mirëpo shtëpitë nuk rrënohen, por do ta shohim si do ta zgjedhim këtë problem, është detyrë e jona dhe do ta bëjmë.

z. Armend Mehmeti, lagja “20 Qershori”, dëshiroj të informohem për statusin e objektit banesor që gjendet përballë objektit të Emergjencës, a ka diçka konkrete lidhur me këtë. Ne nuk jemi uzurpues të atij objekti banesor, kemi qenë të detyruar të vendosemi aty. A do të

ndërmarrni diçka lidhur me statusin e objektit. Për planin e rregullimit të banesave dua të di se a përfshihet edhe objekti ynë banesor.

z. Bujar Hasani, në planin e rregullimit të banesave është edhe objekti që e ceku parafolësi, mirëpo problemi është se për këtë objekt nevojiten investime më të mëdha, jo vetë fasadimi i saj, ka probleme të brendshme, në infrastrukturën e saj.

z. Armend Mehmeti, lagja "20 Qershori", kemi parë një gatishmëri nga ana e Juaj për rregullimin e objektit banesor, mirëpo nëse nuk bëhet rregullimi i kulmit atëherë fasadimi do të priset brenda 2 viteve, çështja e parë është rregullimi i kulmit dhe drenazhi i objektit e pastaj vjen fasadimi. Rregullimi i brendshëm është në rregull, është investuar nga vet banorët.

z. Bujar Hasani, në momentin që do të lidhim kontratën e prokurimit, do të dalim në terren dhe do të vlerësojmë cili pozicion është më i rëndësishëm, kulmi apo fasadimi apo pjesët e brendshme të atij objekti, sepse edhe në qendër kanë probleme me kulme. Kur të fillojmë me punë do të dimë gjendjen reale në terren.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, jemi në dijeni për situatën aty, ju jeni qytetarë të Komunës dhe duhet të gjejmë rrugë ligjore për zgjidhje të problemit.

z. Enver Latifi, përfaqësues i lagjes së qytetit "Podujeva 3", e përgëzojë Kryetarin dhe stafin e tij për punët e mira që i paraqiti, se a ka vend për përmirësim, natyrisht që ka dhe do të zgjidhen gradualisht. Unë kam dy kërkesa: te rruga "Ali Ajeti, te fusha e sportit për ta bërë një kopsht apo çerdhe dhe kërkesa tjetër është që ne përfaqësuesve të fshatrave dhe lagjeve të qytetit të mos na ngarkojë Administrata komunale me dorëzimin e kopjeve të letërnjoftimeve, me rastin e paraqitjes së kërkesave të ndryshme për komunitetet.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës; hapësirat rekreative dhe sportive nuk guxojmë ti mënjanojmë sepse janë nevoja të qytetarëve. Në rast se ka hapësirë tjetër shtesë që duket se ka aty atëherë ne mund ta fusim në projektet tona buxhetore një objekt të çerdhes i cili do tejet objekti i tretë në Komunën e Podujevës. Mendoj që edhe gjeografikisht është e nevojshme për një çerdhe aty. Një OJQ më ka premtuar dhe shpresoj që do të përfitojmë një çerdhe.

z. Behxhet Musliu, nga fshati Llaushë; ka 20 vite nuk e kemi ndie dorën e pushtetit, gjatë periudhës së dimrit një rrugë prej 200 m është e pakalueshme. Mundësisht të shtrohet me zhavorr. Gjithashtu nuk kemi kanalizim (4 shtëpi) për shkaqe të partive politike.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës; rruga e cekur nga parafolësi do të kryhet në afatin sa më të shkurtër. Të dhënat për rrugë dhe kanalizim të përcillen te drejtori i DSHPMSh dhe ai problem do të zgjidhet.

z. Vail Shala, fshati Kunushec; theksoi, tri rrugë të fshatit që janë cekur më parë me 400 m gjatësi nuk e di a janë në prioritet për asfaltim, kam edhe dy kërkesa tjera, në lagjen "Shala" te varrezat në rastet e shirave të rrëmbyeshëm bartet dhe hyn në shtëpi të lagjes sonë, andaj është e nevojshme të intervenohet dhe të merren masat nga autoriteti komunal, kërkesa tjetër është për rregullimin e një ure.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës; lidhur me kërkesën për urën, mundësisht të shfrytëzohet ura e vjetër, pasi që kemi disa lokacione shumë më emergjente, e kur të krijohen mundësitë do ta ndërtojmë edhe atë.

z. Fevzi Jetullahu; këtë vit kanë qenë të planifikuar 11 ura dhe kalesa dhe kjo veç proceduar. Për vitin e ardhshëm na nevojitet buxhet rreth 200,000 € për ndërtimin e urave në bazë të kërkesave të qytetarëve.

z. Enver Kosumi nga fshati Zhiti; jetoj në rrugë "Fitorja" në qytet. Në lagjen ku banojë është mungesë e ujit edhe pse rrjetin e ujësjellësit e kemi bërë vet banorët. Kërkesa tjetër është për një rrugë afër 4 km në fshatin Zhiti, ku rruga njëherit është edhe kusht për të investuar atje. Projektin e kemi dorëzuar në vitin 2014. Me plotësimin e kushteve jemi të interesuar për të investuar në fshat.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës; jemi në dijeni se çështja e ujit është problematike në disa pjesë të qytetit, ndër to edhe rruga "Fitorja". Ju premtoj se brenda dy muajve Ujësjellësi Rajonal "Prishtina" do të vendos gypin e ri 400, i destinuar drejtpërsdrejti për

qytetin e Podujevës. Në takimin që kemi pasur me Drejtorin Regjional na është premtuar se shumë shpejtë do të përfundojë vendosja e gypit, ku pastaj do të ketë ujë të mjaftueshëm dhe do të zgjidhet problemi. Detyrë e juaja mbetet që t'i vejnë njësorët matës, ku këtu do të ndihmojë edhe kompania por mund të kyçemi edhe ne, me qëllimin e vetëm që të përfshihen në sistem të furnizimit, sepse është evidente se ka keqpërdorime të ujit. Çështja e rrugës në fshatin Zhiti është problem për këtë vit. Për vitin tjetër kemi disa projeksione që kemi paraparë në atë zonë, por nuk jam në dijeni se çfarë mund të bëjmë. Është fakt se zona e fshatit është pitoreske, por numri i banorëve është shumë i vogël dhe njëherë do të jetë shumë problematike për ta futur në prioritete për shkak të numrit të banorëve, por neve na mbetet për ta mirëmbajtur.

z. Mehmet Fazliu, nga fshati Obrancë; theksoi kemi problem mirëmbajtjen e varrezave të fabrika e tjegullave. Disa vite jemi vetorganizuar në kuadër të mundësive tona, duke kërkuar edhe përkrahje financiare prej qytetarëve për mirëmbajtjen e varreza. Kërkesa është a ekziston mundësia për mirëmbajtjen e tyre, pasi që Bashkësia Islame nuk është në gjendje. Vërejtje kam te trotuaret të cilat janë të bllokuara nga veturat e parkuara, a ekziston mundësia e liritimit të tyre. Ankesa tjetër është për shkak të pamundësisë së furnizimit me ujë për 5-6 shtëpi, këtë problem e kemi ka 2-3 vite.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës; sa i përket mirëmbajtjes së varrezave veç e kemi në projekt, është një shumë e mjeteve dhe do të fillohet me mirëmbajtjen e tyre. Besoj se jemi në proces të përmbylljes së kontraktimit. Për te trotuaret kemi shumë vërejtje, por ajo është punë e policisë. Ne e kemi ngritë stacionin në nivelin më të lartë policor por shërbimet nuk janë askund. Duhet ta pranojmë publikisht se nuk kemi shërbime. Edhe ashtu është ngulfatur qyteti me mbylljen e rrugës kryesore, tani edhe mosfunksionimi i mjaftueshëm i zyrtarëve policorë për t'u marr me qytetarët e pandërgjegjëm që i zënë trotuaret është problematike. Për çështjen problematike të ujit pak më parë dhashë përgjigjen.

z. Fevzi Jetullahu; për çështjen e sistemit të ujësjellësit në rrugën Ibrahim Demolli, fillimisht ujësjellësi ka marr përsipër për realizimin e projektit por nuk u përfundua. Ne jemi duke e përgatitur projektin dhe ky problem do të zgjidhet këtë vit.

z. Fadil Gërguri, përfaqësues i fshatit Siboc i Poshtëm; kam disa çështje për të paraqitur, e para ka të bëjë me lumin në të cilin dikush gjatë verës hedh kimikate dhe kundërmon jashtëzakonisht shumë dhe gjatë kohës së vërshimeve banorët mbesin të bllokuar. Pyetja është se a ka diçka të re rreth lumit. Kam parë edhe kur me rimorkio kanë hedhur mbeturina në lumë. Për Drejtorinë e Urbanizmit kam disa kërkesa për disa rrugë të fshatit. Sipas informacioneve Komuna bën financimin e shumë OJQ-ve, pyetja është a ka organizata joqeveritare që merren me ambientin, për të ndikuar te qytetarët në ndërgjegjësimin dhe vetëdijësimin të mos hedhin mbeturina dhe të mos dëmtojnë ambientin.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës; dua të jap një përgjigje për çështjen e fundit të shtruar nga parafolësi, për këto tjerat do t'i jap Drejtori i DSHPMSh, pyetja është se kur do të ndalet kjo dukuri, kjo ndalet atëherë kur ti dhe unë i bëhemi polic të vetvetes. Në momentin që sheh personin duke hedhur mbeturina e fotografon dhe e procedon te autoritetet. Ne vet duhet të vetëdijësohemi. Në momentin që haset në ata persona duke pasur dëshmi, atëherë do të sanksionohen, është Drejtoria e Inspeksionit që do të merret me ta.

z. Fevzi Jetullahu; sa i përket çështjes së trajtimit të lumenjve, ju njoftoj se më datën 28 të këtij muaji hapet tenderi, dhe do të trajtohen vendet ku ka pasur vërshime, pikat e zeza, ato janë të identifikuar dhe besoj se s'do të ketë më probleme. Ndërsa sa i përket rrugëve me to do të merret Drejtoria e PUMM.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, këtu kam projektin për fshatrat Siboc, Lluzhan ku janë mbi 1 km e 87 m për asfaltimin e 5 rrugëve me një kosto 60,000 €.

z. Abis Potera, banor në rrugën "Zahir Pajaziti", shtroi çështjen e legalizimit të objektit / shtëpisë, në qendër të qytetit, duke theksuar se nuk është duke u aprovuar nga Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës; z. Potera, duhet të paraqiteni te Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, pasi që është çështje individuale, e trajtoni në kuadër të Drejtorisë.

z. Xhafer Ademi, përfaqësues i komunitetit të ashkalive, romëve dhe egjiptasëve në Komunën e Podujevës; theksoi, kam disa kërkesa;

- Për ndërrimin e gypave të ujit, sepse ne pimë ujë me përmbajtje kancerogjene, sepse gypat janë një kohë të gjatë dhe janë kalbur. Jemi të detyruar për të blerë ujë të pijes.

- Për rregullimin e disa rrugicave në kubëza

- Rruga pas ndërrimit të gypave të ujit të rregullohet sërish/asfaltohet.

- Në kuadër të mundësive Komuna të na ndaj 1 ha për ndërtimin e shtëpive, sikurse është bërë në lagjen e Kuvajtit. Financimi i shtëpive do të bëhet nga ne, jemi organizatë joqeveritare ku do të sigurojmë donacione në bashkëpunim me Komunën. Ka raste ku 20 anëtarë të familjes jetojnë në një dhomë.

-Hapja e qendrave mësimore, të cilat janë mbyllë, e që kanë funksionuar nga viti 2008. Jam i pari që kam bërë hapjen e qendrave, kur nuk kemi pas asnjë nxënës në shkolla të mesme, e që për një kohë të shkurtër kam arritur që të vijojnë mësimin 20 nxënës në shkolla të mesme.

- Për punësimin e pjesëtarëve të komunitetit pakicë në Komunë, sepse deri më tash është vetëm një i punësuar.

z. Fevzi Jetullahu; sa i përket çështjes së ujësjellësit duhet të bëhet projekti i ri për tërë lagjen dhe jemi duke punuar në atë drejtim dhe shpresojmë të realizohet këtë vit. Gjithashtu parashihet edhe asfaltimi apo riparimi i atyre rrugëve ku parashihet nevoja. Sa i përket rregullimit të rrugëve me kubëza, projekti është në fazën e vlerësimit.

z. Avni Fetahu, sa i përket qendrave mësimore, ne kemi bërë kërkesë në Ministrinë relevante, por në të njëjtën kohë është arritur marrëveshje që deri në fund të këtij muaji të bëhet pagesa e tutorëve që janë nga komuniteti i juaj edhe për tu realizuar mësim shtesë. Në të njëjtën kohë kemi dërguar edhe një projekt në Ministri dhe mendojmë se do të gjejmë përkrahje për një objekt të veçantë për komunitetin e juaj për mësim shtesë afër shkollës “ Ibrahim Rugova”

z. Xhafer Ademi; unë nuk kisha paraparë që nxënësit e komunitetit të dalin jashtë shkolle, por duhet të jenë objektin shkollorë, aty duhet të jenë qendrat e jo jashtë objektit.

z. Avni Fetahu; janë dy qendra mësimore që janë brenda objektit shkollorë, por objekti që parashihet do të jetë ngjitur për shkolle për aktivitete shtesë dhe nuk ka qëllim të ndarjes.

z. Shpejtim Bulliqi Kryetar i Komunës; ne e dimë se këtu jo gjithçka ka qenë në rregull deri më tash. Çështja e Zyrës për komunitete e dimë siç ka qenë por do të punoj në këtë aspekt dhe do ta zgjidhim këtë problem. Zyra për komunitete do të jetë e komuniteteve pakicë.

z. Enver Berisha, nga fshati Kunushec; kam dy kërkesa:

-Asfaltimin e një rruge në lagjen “Fazliaj”, rreth 150 m gjatësi. Ka 4-5 vite që kemi bërë kërkesë dhe e kemi përsëritur edhe këtë vit.

- Kanalizimi që vjen nga fshati Buricë është bllokuar dhe ujërat e zeza janë duke u derdhur nëpër livadhe, andaj kërkojmë të intervenohet nga Komuna.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës; për rregullimin e rrugicave veç dhashë përgjigje.

z. Fevzi Jetullahu; theksoi, është ndërruar një segment i gypave por për shkak të lagështisë madhe aty ka qenë e pamundur të kryhet në tërësi sanimi i kanalizimit. Edhe ashtu është në projekt të kryhet këtë vit.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës; dua të jap edhe një përgjigje shtesë për z.Shefki Zeqirin, përfaqësuesin e fshatit Gërdoc, për punën e ambulantes. Të mos insistohet shumë për ngritjen e objekteve sepse nuk kemi personel. Kemi shumë objekte që nuk po mundemi ti funksionalizojmë për shkak të mungesës së resurseve humane. Gjithashtu jeni në dijeni se duhet respektuar edhe kriteri i distancës së objekteve dhe atë kriter nuk e plotëson fshati Gërdoc. Edhe fshati Dobërdol ka bërë kërkesë për ambulantë por ai gjithashtu ka afër edhe fshatrat Kërpimeh dhe Bajçinë. Ne nuk jemi të interesuar për të ndërtuar objekte dhe për t'i lënë të shkatërrohen, por kur të ndërtohen edhe të funksionalizohen.


z. Musli Dedaj nga fshati Penuhë; kam një kërkesë për rregullimin e një rruge në fshat. Kërkesa është bërë tri vite radhazi. Gjithashtu kam edhe një kërkesë për ndriçim të fshatit. A parashihet në projekt.

z. Skender Imeri nga fshati Llaushë; kam një kërkesë për rregullimin e një rruge me gjatësi prej 2 km, po ashtu kemi mungesë të kanalizimit. Unë kam një fermë dhe po kemi shumë vështirësi në mungesë të infrastrukturës rrugore.

z. Fevzi Jetullahu; operatori ekonomik këtë javë do të dal për të punuar në pjesën e fshatrave Dumnicë dhe Llaushë. Sa i përket rrugës me zhavorr besoj se brenda dy jave duhet të përfundoj, ndërsa sa i përket kanalizimit fillimisht duhet përgatitur projekti dhe mund të vonohet pak.

z. Shemsi Jashari – aktivist i Shoqërisë Civile; theksoi kam dy kërkesa, e para është për një kondicioner në sallë, për shkak të vapës së madhe dhe e dyta si organizatë joqeveritare kemi monitoruar punën e Kuvendit të Komunës dhe njëra prej temave që po zvarritet prej vitit 2013 është ndërtimi i sheshit "Afrim Zhitia". Personalisht jemi marrë me monitorimin e aktiviteteve që sillen rreth ndërtimit të këtij sheshi. Diçka që është bllokuar, çështja qëndron te Komuna – Drejtoria përkatëse për dhënien e lejeve dhe për lirin e pronës për t'u implementuar projekti që financohet prej Ministrisë së Ambientit. Është një kontratë e nënshkruar në mes operatorit ekonomik dhe Ministrisë në vitin 2013 dhe vazhdimisht është zvarritur prej viti në vit ky buxhet. E dimë se në qeverisjen e kaluar përveç arsyeve të arsyeshme kanë pas edhe telashe personale drejtues të drejtorive të caktuara për shkak të afërsisë familjare me ata që kanë uzurpue atë pronë rreth obeliskut të "Afrim Zhitisë". Komuna e ka lëshuar një leje për 4 ari qysh në vitin 2007 për ndërtimin e obeliskut, por në vitin 2013 është nënshkruar kontrata për zgjerimin e asaj pjese në një hapësirë prej 29 ari që është pronë e komunës, pronë e cila nuk implikon asnjë familje qoftë ai edhe uzurpator, me prishur një mur apo shtëpi të dikujt, thjesht është një hapësirë që është dashur të lirohet. Unë kam bërë një kërkesë për qasje në dokumente zyrtare se deri ku ka ecur ky projekt dhe kam marr një përgjigje të përgjithësuar, jo konkrete, desha të kem një përgjigje qoftë nga ju apo drejtori përkatës a do të ndërtohet ky shesh, a do të mundësohet ndërtimi apo jo. Vlera e kontratës së nënshkruar është diku 440,000 € dhe mendoj se për Afrim Zhitin një pronë komunale nuk ishte dashur të jetë problem, një hapësirë publike e cila nuk është në shfrytëzim tjetër.

z. Shejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës; për pyetjen e parë përgjigjja është kjo, ky objekt i Komunës ka dy vite që është lëshuar në përdorim. Është punuar jo siç duhet dhe na ka paraqitur shumë probleme, gjatë tërë dimrit kemi harxhuar edhe rrymë dhe naftë për ngrohje. Dje pata një takim me një operator lidhur me kondicionerin e Komunës dhe kostoja për rregullimin e sistemit të kondicionerit është 16,000 € dhe kjo është rezultat i intervenimeve të mëhershme nga operator të ndryshëm të cilët faktikisht e kanë dëmtuar dhe prishur komplet sistemin. Pra kostoja e rregullimit është 16,000 € pa mirëmbajtje. Stafi i Komunës është në gjendje alarmante në kryerjen e shërbimeve për qytetarët për shkak të temperaturave të larta, prandaj do të mundohemi që ta rregullojmë, mirëpo është si pasojë e menaxhimit "të mirë" që e ka bërë pushteti i kaluar. Megjithatë nuk është i vetmi rast, janë edhe disa komuna tjera që e kanë të njëjtin problem. E dyta, për atë që e kërkuat, unë kam dhënë përgjigje para këshilltarëve të Kuvendit komunal, nuk ka uzurpim prone te obelisku "Afrim Zhitia". Komuna e Podujevës e ka kryer punën, ka ndarë një sipërfaqe për ndërtimin e obeliskut dhe obelisku është ndërtuar. Është vendimi i Kuvendit për sipërfaqen e ndarë. Se çka kanë bërë më tutje, se kush ka hartuar projekt pa ndarje të sipërfaqes, pa vendime të Kuvendit komunal, nuk jam në dijeni. Është sipërfaqja që është dhënë në dispozicion, mund të bëjnë lloj lloj projekti për sipërfaqen e ndarë zyrtarisht nga Kuvendi i Komunës. Nuk kam përgjigje tjetër, nuk ka asnjë pengesë, është formuar një komision para pak ditësh nga Kuvendi, i cili ka dalë në terren, e ka parë gjendjen dhe ka konstatuar se nuk ka uzurpime dhe asgjë që është problematike. Është prona e ndarë dhe ata është dashur ta adaptojnë projektin konformë sipërfaqes së pronës që e kanë pasur në dispozicion. Jemi të hapur lidhur me këtë çështje, çdo



gjë është transparente dhe publike, andaj nuk ka nevojë me politizue. Unë sot kisha familjen e heroit Afrim Zhitia në zyrë para mbledhjes dhe biseduam për kërkesat e familjes, ku do të punojë në realizimin e kërkesave të saj.

z. Shemsi Jashari – aktivist i Shoqërisë Civile; Ministria ka bërë kërkesë në adresë të Komunës për t'i mundësuar implementimin e atij projekti, po flasim për 440,000 € buxhet nga Ministria. Kuvendi Komunal ka marr një vendim ku kërkon prej Ekzekutivit mundësinë e realizimit të këtij projekti. Për publikun është interesant të dijë se Komuna nuk lejon zgjerimin e këtij projekti, 4 ari janë nda në vitin 2007, 29 ari është projekti që është pronë e Komunës dhe që nuk lejohet me u zgjerua. Si rrjedhim mjetet e ndara për këtë projekt nuk mund të shfrytëzohen.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës; z. Jashari ti nuk je individ që nuk ke njohuri se si zhvillohen proceset dhe dokumentacioni, ju i kuptoni procedurat dhe ato janë në rregull.

z. Shemsi Jashari – aktivist i Shoqërisë Civile; unë i kuptoj procedurat, por një projekt për heroin Afrim Zhitium, duke njohur kontributin e tij për këtë vend dhe prona komunale që nuk shfrytëzohet për diçka në të mirën publike nuk do të ishte dashur të jetë peng i procedurave burokratike, i kërkesave me kohë ose pa kohë.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës; Afrim Zhitia është më shumë i imi se sa i yti, por Afrim Zhitia nuk është as i imi as i yti por i të gjithëve të Kosovës.

z. Rrahman Shala, nga fshati Bajçinë; theksoi, vitin e kaluar na është asfaltuar rruga, por aty ku është ndërprerë asfalti dhe deri te shtëpia ime grumbullohet uji. Kërkesa ime që të shtrohet me zhavorr, por paraprkasht vendosja e disa gypave për ta larguar ujin.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, mbas takimit lajmërohu te Drejtori i DSHPMSh, besoj se do të bëhet zgjidhja.

Nëse nuk ka tjerë të interesuar të marrin fjalën, unë ju falënderoj shumë për ndihmën sugjerimet dhe vërejtjet e paraqitura dhe besoj se të gjitha kërkesat do t'i inkorporojmë brenda mundësive. E përmbyllim takimin duke ju falënderuar të gjithëve për pjesëmarrje dhe kontribut.

Mbledhja përfundoi në orën 12.30

**Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani**

**Nr. 02-060/04-0055121/21
Podujevë, 24.06.2021**



